

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

BULETINI INFORMATIV

PRILL 2023

**NË KUADËR TË 8 PRILLIT “DITËS NDËRKOMBËTARE TË ROMËVE”
QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE U ANGAZHUAN MBI TAKIME
DHE EDUKIM LIGJOR ME BANORËT E KËTIJ KOMUNITETI.**

SHKODËR



Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër, në kuadër të 8 Prillit realizoi një takim me banorët e këtij komuniteti.

Problematikat më të shpeshta që u evidentuan gjatë këtij takimi janë regjistrimi i fëmijëve, ndryshim dhe njohje atësie/amësie.



KUKËS

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kukës, në kuadër të 8 Prillit realizoi një takim me banorët e këtij komuniteti.

Problemet që u evidentuan gjatë këtij takimi janë regjistrimi civil, papunësia, analfabetizmi si pasojë e jo arsimit, problemet e shëndetësore e duke vijuar më tej me kushtet e këqia të jetesës, aksesin e ulët në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe të strehimit.



VLORË



Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë, në kuadër të 8 Prillit "Ditës Ndërkombëtare të Romëve" zhvilloi takim në terren në Njësinë Administrative Shushicë, në fshatin Risili dhe Lllakatund ku janë të përqendruar qytetarë të komunitetit Rom.

Problematikat që qytetarët ndanë kishin të bënin me strehimin, përfitimin e pensionit të invaliditetit dhe problematika me njohjen e viteve të punës.

TIRANË

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë zhvilloi një takim informues ndaj Komunitetit Rom në disa zona të qytetit të Tiranës. Gjatë këtij takimi u shpërndanë fletëpalosje, si dhe nga ana e tyre u tregua interes për të përfituar ndihmë juridike falas, duke e vijuar dhe më gjerë informacionin tek të afërmit e tyre.



LEZHË



Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lezhë mori pjesë në aktivitetin e mbajtur në ambjentet e Qendrës Kulturore të femijeve Lezhë. Të pranishëm në këtë takim ishin Kryetari i Bashkisë z. Pjerin Ndeu, përfaqësues të institucioneve si edhe qytetarë të këtij komuniteti.



FIER

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier zhvilloi një aktivitet në bashkëpunim me Bashkinë Roskovec, Sektorin e Qendrave Social-komunitare, me teme "Njohja mbi të drejtat e tyre dhe mundësia për të përfituar nga ndihma juridike e garantuar nga shteti".

Njohja e traditave të komunitetit Rom u prezantua nga vet kjo pakicë kombetare.





ELBASAN

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Elbasan zhvilloi një aktivitet promovues pranë ambienteve të Shoqatës Levizja Rinore Egjyptiane & Rome ku të pranishëm ishin edhe nxënësit e shkolles " Vasil Kamani ".

GJIROKASTËR




Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastër në kuadër të 8 Prillit "Ditës Ndërkombëtare të Romëve" zhvilloi një aktivitet promovues pranë zonave të banimit të këtij komuniteti, me pjesëmarrjen e perfaqësuesve nga Bashkia Gjirokastër dhe av. Elona Frëngu.



POGRADEC

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec mori pjesë në panelin folës në aktivitetin e zhvilluar nga Bashkia Pogradec me temën " UNE JAM ROM", me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Bashkise Pogradec dhe institucioneve të tjera kyçe lokale.

Ky takim kishte qëllim informimin e shërbimeve të ofruara nga Qendra lidhur me problematikat që hasin me së shumti kjo kategori.



KORÇË

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë në kuadër të 8 Prillit "Ditës Ndërkombëtare të Romëve" mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Drejtoria e Kujdesit Social.

Pjesëmarrësit e komunitetit Rom u informuan rreth funksionimit të Qendrës, u diskutuan problematikat e tyre, ku u evidentuan problemet dhe vështirësitë në çështjet e pronësisë, kujdestarisë dhe përfitimit të ndihmës ekonomike.



BERAT

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Berat zhvilloi një aktivitet promovues me pjesëmarrjen e Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Komunitetit Rom.

Ky takim u shfrytëzua për tu njohur me ligjin 111/2017 "Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti", shërbimet që ofrohen, vendodhjen e Qendrës si dhe u evidentuan problematikat kryesore që kjo kategori përfituese ka.



LUSHNJË

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnjë mori pjesë në një aktivitet të organizuar me ftesë të projektit Romacted. Të ftuar ishin antarë të komunitetit Rom, kryebashkiakja dhe deputetë të qarkut.

Ky takim shërbeu për njohjen e metejshme me ligjin 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" dhe problematikat konkrete të komunitetit rom dhe egjiptian.





Në datën 03.04.2023, Qendra Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier dhe Bashkinë Fier me temë: “Aksesi në sistemin e drejtësisë dhe garantimi i sigurisë së viktimave të dhunës në familje, në kuadrin e hartës së re gjyqësore dhe riorganizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”.

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë, në datën 24.04.2023, organizoi një takim informues me Administratorët Shoqëror pranë Njësive Administrative të Qarkut Korçë.



Në datën 27.04.2023 Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lezhë mori pjesë në një takim të organizuar ne kuadër të koalicionit antidrogë që është formuar në qytetin e Lezhës, në bashkëpunim me shoqatën 'YWCA of Albania' dhe 'CADCA' si dhe Drejtorinë e Shërbimit Social.

INTERVISTA TË ZHVILLUARA GJATË MUAJIT PRILL 2023



Në datën 27.04.2023 Drejtori i Përgjithshëm Z.Qirici dhe punonjëset me trajnim të posaçëm pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier dhe Gjirokastrë, me pjesëmarrjen e koordinatorëve të UNDP kanë dhënë intervistë për News 24, Radio Televizioni Shqiptar dhe median lokale Radio Televizioni Gjirokastra, mbi shtrirjen dhe funksionimin e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, rastet e trajtuara dhe shërbimin e ofruar nga këto Qendra.

